

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Punë

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Sistemimi i varrezave Himarë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
45215400-1 Punime ndërtimi për varreza.

VLERA E FONDIT LIMIT: 7 071 350 (shtatëmilion e shtatëdhjetenjë mijë e treqindpesëdhjetë) **lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor: **Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26 dhe 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për ekzekutimin e kontratës, të lëshuar nga autoritetet kompetente, Liçensë për zbatim punimesh:

Kategoria	Klasifikimi	Emërtimi
NP 1	A	Punime gërmimi në tokë
NP-3	A	Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godina civile e industrial, veshje fasada
NS-1	A	Punime për prishje ndërtimesh
NS-4	A	Punime rifiniture të muratës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë autoritetit kompetent, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Në zbatim të VKM nr. 28, datë 20.01.2016 “Për shpalljen e Qendrës Historike Himarë”, si dhe Ligjit Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, punimet e zbatimit që do të kryhen ne varrezat e qytetit Himarë, janë pjesë e zonës së Qendrës Historike të këtij qyteti dhe operatori ekonomik duhet të jetë i licencuar në përputhje me Ligjin Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” me kategorinë N-Z/A/7 “Për ndërhyrje në zonat muzeale/qendrat historike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se ”1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”, nenin 39, pika 6, gërma (a), të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se ”6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore”, Ligjin Nr. 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” datë 10.09.1998 të ndryshuar, VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” të ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Në bazë të licencës profesionale të shoqërisë tregohet aftësia teknike e profesionale e realizimit të kontratës që prokurohet dhe pikat e kërkuara të licensës janë përcaktuar nga vlera e punimeve që do të realizohen si dhe nisur nga natyra e punëve që do të kryhen sipas zërave të preventivit. Nisur nga fakti që vlera e objektit është më e vogël se 20 milion lekë për kategoritë e punimeve, është zgjedhur niveli i klasifikimit ”A” që i përgjigjet kësaj vlere.

Në zbatim të VKM nr. 28, datë 20.01.2016 “Për shpalljen e Qendrës Historike Himarë”, si dhe Ligjit Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, punimet e zbatimit që do të kryhen ne varrezat e qytetit Himarë, janë pjesë e zonës së Qendrës Historike të këtij qyteti dhe për këtë arsye është kërkuar që operatori ekonomik duhet të jetë i licencuar në përputhje me Ligjin Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” me kategorinë N-Z/A/7 “Për ndërhyrje në zonat muzeale/qendrat historike.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 OE duhet te paraqese vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e xhiros vjetore duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit. Kërkesa për plotësimin e kapacitetit financiar konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës...”; nenin 43 pika 2/c dhe pika 3, nenin 55 pika 4 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar ku parashikohen se:

“2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme”.

“3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor”.

“Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c)

40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...”.

Në nenin 55 pika 4 të VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: *“Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.*

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron është vendosur konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve 2022, 2023 dhe 2024 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkojnë një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”,* si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *“.....Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji”,* si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar dhe nenit 14 të Ligjit Nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar.

Ky kriter, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për:

- një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 29 % e vlerës së përllogaritur të kontratës dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore;
- Aktin e kolaudimit;
- Certifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përfundimtar.

Shënim: Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore;
- Akt kolaudimi objekti.

➤ Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontraten e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.

➤ Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se ”4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar ku parashikohet se

”Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: a) Për kontratat e punëve:

i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit⁵⁷ që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 29 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar nenit 55 pika 4 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar është përcaktuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 29 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 15 (pesëmbëdhjetë) persona, gjatë muajit Maj 2025.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje, pas mbylljes së fazës së vlerësimit, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, të gjithë dokumentacionin provues si më poshtë:

- *Listëpagesës sipas formularit satandart për sigurimet për muajin Maj 2025.*
- *Vertetim nga administrata tatimore për numrin e punonjësve të siguruar për muajin Maj 2025.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se *”4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se „6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe

profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë:

Sasia e orëve të punës mbështetur në preventiv, manualin e çmimeve të ndërtimit dhe analizat e kostove është $3\,840 \text{ orë} : 8 = 480 \text{ ditë pune}$. Afati i punimeve do të jetë 40 ditë kalendarike. Atëherë $480:40=12$ punëtorë dhe duke llogaritur stafin drejtues (Administrator, Inxhinier ndërtimi dhe Inxhinier gjeodet) është gjykuar për të kërkuar 15 punëtorë.

Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shpëputje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

- Agronom 1 (një)
- Teknik Ndërtimi 1 (një)
- Murator 1 (një)
- Karpantier 1 (një)
- Saldator 1 (një)

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve të mesiperm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje, pas mbylljes së fazës së vlerësimit, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, të gjithë dokumentacionin provues si më poshtë:

- Kontratë Individuale të Punës (të vlefshme)
- Dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme), të lëshuara sipas legjislacionit në fuqi të njohur nga Republika e Shqipërisë, Institucione Shtetërore ose organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë.
- Për agronomin, diploma.
- Për Teknikin e Ndërtimit, diplomë ose listë notash.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë

zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se „6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.

si dhe VKM Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, Urdhërin Nr. 109, datë 05.08.2013 ”Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, pasi për kryerjen e punimeve të veçanta sipas zërave të preventivit kërkohej specialistët e sipërpërmendur.

Qëllimi i vendosjes së këtij kriteri është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve, volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të percaktuara në specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore. Certifikimet/diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr.15/2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”.

2.3.4 Operatorët ekonomikë, për të vërtetuar se punët, objekt prokurimi i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Konkretisht:

- *Certifikat e sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015;*
- *Certifikat e sistemit të menaxhimit të mjedisit ISO 14001:2015;*
- *Certificate per Menaxhimin e Shendetit dhe Sigurise ne Pune ISO 45001-2018*
- *Çertifikate e Sistemit të Integruar të menaxhimit BS PASS 99:2012*

Në rastet e bashkimit ekonomik të operatorëve, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë përkatësisht Certifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Kontratës së Bashkëpunimit.

Të gjitha certifikatat e mësiperme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësiperme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale”

“1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit”.

nenin 44, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lid, janë kërkuar këto certifikata me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të mjedisit”.

Duke marrë në konsideratë faktin se standarti S SH EN ISO 14001:201, “Sisteme të menaxhimit të mjedisit”, SSH EN ISO 9001: 2015 “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë” dhe SSH EN- ISO 45001:2023 “Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë” dhe PASS 99:2012 “Sistemi i menaxhimit të integruar”, specifikojnë kërkesat për sistemin e menaxhimit të mjedisit, sistemin e menaxhimit të cilësisë, sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë dhe sistemin e menaxhimit të integruar, për t’i krijuar mundësinë një organizate të zhvillohet dhe të implementojë (ose zbatojë) një politikë dhe objektiva të cilat marrin parasysh kërkesat ligjore dhe kërkesa të tjera në lidhje me aspekte të rëndësishme mjedisore, vlerësohet se plotësimi i këtij standarti lidhet ngushtësisht me objektin e prokurimit, duke krijuar siguri që punimet do të jenë konform standarteve të kërkuara, për mbrojtjen e mjedisit ku do të përdoren, mbrojtje e cila ndihmon në parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të banorëve apo garantimin e kryerjes me cilësi të punimeve dhe mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë të punonjësve dhe jo vetëm.

Për vetë natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët të realizojnë objektin e kontratës me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, të mjedisit, i sigurisë në punë dhe menaxhimit të integruar janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit përgjegjës për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë

dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Kriteri i mësipërm për paraqitjen e këtyre certifikatave është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese për operatorët.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

<i>Kamion veteshkarkues me vinc kapacitet mbajtës (mbi 5 ton)</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kamioncinë me kapacitet mbajtës (deri 3 ton)</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Eskavator me goma</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autobetoniere</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Fabrike prodhim betoni</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi /me qera, ose kontrate furnizimi</i>
<i>Motobetoniere</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Depozitë uji >= 5000 litra</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kokore</i>	<i>10 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kuti e ndihmës së shpejtë</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje, pas mbylljes së fazës së vlerësimit duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, të gjithë dokumentacionin provues si më poshtë:

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

- dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit;*
- leje qarkullimi;*
- certifikaten e kontrollit teknik;*
- siguracionin e mjetit.*

b) Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet:

- dokumenti që vërteton regjistrimin e tij;*
- leje qarkullimi;*
- certifikaten e kontrollit teknik,*
- siguracionin e mjetit.*

Mjetet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

c) Mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin certifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkaëese.

d) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.

- e) *Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës që prokurohet dhe afati i saj.*
- f) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- g) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit.*
- h) *Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedura të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se ”4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se ”6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

Nëpërmjet kësaj kërkesë, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kane në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qellim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Lloji dhe numri i mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës është përcaktuar duke u bazuar në zerat e preventivit dhe specifikimeve teknike. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të preventivit. Përcaktimi i paisjeve dhe makinerive është bërë duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre” (ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018), si dhe hapësirat fizike rreth objektit, mundësive të manovrimit me mjete të rënda, urbanizimit për efekt të zhurmave dhe ndotjes etj.

Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shitjes, Kontratës së Qirasë apo Huapërdorjes. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

Zërat e radhitura në përmbajtje, janë pjesë dhe përshkrime të detajuara të vizatimeve të bëra nga projektuesi si dhe specifikime të tjera të mundshme të kategorive të ndryshme punimesh. Standartet e përdorura në këtë “Specifikim Teknik”, nuk kanë qënë mbështetur vetëm në vizatimet por dhe në manualet ligjore dhe libra të tjerë keshillues si:

- Manuali i ri sipas VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 “Per krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informalizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve”.
- Hartimi i preventivit nga manuali i çmimeve në ndërtim bazohet në të dhënat e manualit të çmimeve për katër elemente të strukture të kostos si dhe nga analizat e reja të hartuara nga projektuesi.

Hyrja në sheshin e ndërtimit: Gjate gjithë kohës së zbatimit të punimeve, Kontraktori duhet të organizojë punën për lëvizjen e njerëzve në sheshin e ndërtimit. Sheshi i ndërtimit duhet të jetë i rrethuar me shirita që njoftojnë publikun për kryerjen e punimeve. Kontraktori nuk duhet të lejojë hyrjen e personave që nuk ka lidhje me ndërtimin, me shpenzimet e veta duhet të marrë të gjitha veprimet e mundshme për të siguruar ruajtjen e ambjentit nga ndotjet e ndryshme gjatë punës dhe sigurimin e lëvizjes normale të publikut.

Punime gërmimi: Zbankim dhe rrafshim dheu, i kryer me krah dhe transport me karo dore, në truall të cfarëdo natyre dhe konsistence, i tharë ose i lagur (argjile edhe n.q.s. është kompakte, rërë, zhavorr, gurë etj.), duke përfshirë prerjen dhe heqjen e rrënjëve, trungjeve, gurëve dhe pjesëve me volum duke përfshirë dhe plotësuar detyrimet në lidhje me ndërtimet e nëndheshme si, tubacionet në përgjithësi etj, përfshirë spostimin brenda ambientit të kantierit. I gjithë materiali i tepërt i gërmuar do të largohet në vendet e aprovuara nga Autoriteti Kontraktor.

Punime murature

Llaçi (*Sasia për 1m³*)

Llaç bastard marka 15 me rërë natyrale lumi (me lagështi, shtesë në volum 20% dhe porozitet 40% e formuar me çimento: gëlqere: rërë në raporte 1:0,8:8. Gëlqere e shuar lt 110, çimento 300 kg 150, rërë m³ 1,29.

Llaç bastard marka 25 me rërë natyrale lumi (me lagështi, shtesë në volum 20% dhe porozitet 40%) e formuar me çimento: gëlqere: rërë në raporte 1:0,5:5,5. Gëlqere e shuar lt 92, çimento 300 kg 212, rërë m³ 1,22.

Llaç bastard marka 15 me rërë të larë (porozitet 35%) e formuar me çimento, gëlqere, rërë në raporte 1:0,8:8. Gëlqere e shuar lt 105, çimento 300 kg 144, rërë m³ 1,03.

Llaç bastard marka 25 me rërë të larë (porozitet 35 %) e formuar me çimento: gëlqere, rërë në raporte 1:0,5:5,5. Gëlqere e shuar lt 87, çimento 300 kg 206, rërë m³ 1,01.

Llaç bastard marka 1:2 me rërë të larë (porozitet 35%) e formuar me çimento, rërë në raporte 1:2. Çimento 400 kg 527, rërë m³ 0,89.

Raportet e mësipërme për llacin, përdorur për punimet e ndërtimit dhe referuar zërave specifike, janë të vlefshme për 1 (një) m³ volum.

Këto standarte bazohen në Manualin nr.1 “Analizat Teknike për prodhimin e materialeve të ndërtimit, udhëzime dhe kritere”.

Raportete mëposhtme për betonin, përdorur në punimet e ndërtimit dhe referuar zërave specifike, janë të vlefshme për 1 (një) m³ volum beton me çimento të zakonshme Portland. Këto standarte bazohen në broshurën “Projektimi i Betoneve të Zakonshme, K.T. 37-75”, daë Tiranë 1980 (Republika e Shqipërisë - Ministria e Ndertimeve I.S.P.Nr. 1)

Mur guri, në lartësi derrinë 3m me llaç cimentoje M-25

Muraturë me gurë, me trashësi 50 cm dhe llaç bastard m-15 sipas, me dozim për m³: gurë, llaç m³ 0,10, çimento 400 kg 14 dhe ujë, përfshirë çdo mjeshtëri për dhëmbët e lidhjeve, qoshet, dhe çdo gjë tjetër të nevojshme për mbarimin e muraturës dhe realizimin e saj në mënyrë perfekte.

Punime beton/armeje për brezat e mureve, themeleve

Betoni (*Sasia për 1m³*)

Beton marka 200 me *inerte*, konsistencë 3-5 cm, granil deri 20 mm, rërë e larë me modul 2,6: Çimento 400 kg 300, rërë e larë m³ 0,43, granil m³ 0,69, ujë m³ 0,18.

Beton marka 200 me *inerte*, konsistence 3-5 cm, granil deri 20 mm, rërë e larë me modul 2,6: Çimento 400 kg 370, rërë e larë m³ 0,43, granil m³ 0,69, ujë m³ 0,185.

Betoni duhet të lëvizë nga vendi i përgatitjes në vendin e vendosjes përfundimtare sa më shpejtë të jetë e mundur.

Brez b/a monolit C16/20

Armatura ose kallëpet duhen të jenë në përshtatje me profilet, linjat dhe dimesionet e betonimit, armatura duhet të jetë e fortë për ti qëndruar forcës së betonit dhe ngarkesës konstruktive. Brezat të realizuara dhe të armuara në mënyrë të rregullt sipas udhëzimeve në projekt, formuar me beton m-200 deri në lartësinë, të hedhur në vepër në shtresa të holla dhe të vibruara mirë, me dozim sipas, duke përfshirë, kallëpet, pëerforcimin, hekurin e armaturës si dhe çdo detyrim tjetër për mbarimin e punës në mënyrë perfekte.

Hekur betoni

Punime hekuri për të gjithë elementët prej betoni të armuar që prodhohen në kantier, me hekur me karakteristika celik C-3 me Ra=2100 kg/cm², në dimensionet dhe forma sipas elementeve të projektuara në fletët përkatëse të projektit dhe sipas të gjitha kushteve teknike në fuqi si normativat e kthimit të ganxhave, të zgjatimeve për hekurit me përmasa të gjatë etj., për lëndë të parë (hekur) të shoqëruar me certifikatat e provave laboratorike për karakteristikat që duhet të plotësojë, hekur pa përmbajtje ndryshku duke përfshirë çdo punë apo kërkesë tjetër për ta konsideruar punimin e hekurit të përfunduar në mënyrë perfekte.

Ndërtim kangjella me konfiguracin mesatar për rrethim

Ndërtimi i kangjellave do të bëhet mbi brezin e betonit të vendosura drejt në lartësinë e përcaktuar në projekt, kollonat e hekurit do të kapen në brezin e betonit, panelet do të jenë 2.5m gjatësi dhe 1 m lartësi celik të zinguar 4mm, për realizimin sa më mirë të kësaj pune do të kryhen konsultime me mbikqyrësin e punimeve si dhe me persona të autorizuar të Autoritetit kontraktor.

Shtrese betoni C16/20 me zgarë hekuri $t=10\text{cm}$

Betoni pasi të jetë përzier mirë të transportohet në vendin e punës sa më shpejt, i ngjeshur mirë të krijojë sipërfaqe të lëmuara, pa vrima dhe xhepa ajri. Vibratorët duhen të vendosen vertikalisht në beton të bëhet ngjeshja sa më e mirë me kujdes dhe të bëhet me nimeli dhe pjerrësi në mënyrë perfekte. Trashësia minimale 10cm.

Gjerësia e rrugicave do të ndryshojë sipas vendeve në varreza.

Suvatim i jashtëm në mur guri

Sprucim i mureve për muraturë, me llaç çimentoje të lëngët për përmiresimin e ngjitjes së suvasë dhe rforcimin e sipërfaqeve të muraturës, duke përfshirë skelat e shërbimit dhe çdo detyrim tjetër për ti dhënë plotësisht fund sprucimit. Suvatimi i realizuar nga një shtresë me trashësi 2 cm, llaçi bastard m-25 me dozim për m^2 : rërë e larë m^3 0,005, llaç bastard m^3 0.03, çimento 400 kg 7.7, ujë, e aplikuar, në bazë të udhëzimeve të përgatitura, në mure, dhe e lëmuar me mistri e bërda, duke përfshirë skelat e shërbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ti dhënë plotësisht fund suvatimit në mënyrë perfekte. Suvatim i realizuar nga një shtresë me trashësi 2 cm llaci bastard m-25 me dozim për m^2 : rërë e larë m^3 0,005, llaç gëlqereje m-1:2 m^3 0.03, çimento 400 kg 6.6, ujë, i aplikuar, me paravendosje të drejtuesve në mure, dhe e lëmuar me mistri e bërda, duke përfshirë skelat e shërbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ti dhënë plotësisht fund suvatimit në mënyrë perfekte.

Projekt, duke përfshirë kallepet ose fashaturat e mundshme si dhe çdo detyrim tjetër për ti dhënë plotësisht fund xokolaturës në mënyrë perfekte.

Lyerje me bojë vaji

Kollonat e hekurit do kruhen dhe lëmim me dy duar boje vaji dhe sipërfaqeve metalike të rrethimit, të portave dhe çfarëdo sipërfaqe metalike, patinimeve dhe elementeve prej hekuri me stuko të përshtatshme për përgatitjen e sipërfaqeve për lyerjen me bojë vaji. Lyerje e elementeve prej hekuri, me bojë të përgatitur me nje dorë minio plumbi ose me antiruxho në formën e vajit sintetik, me dozim për m^2 kg 0.080. Lyerje me bojë vaji sintetik, për metalike dhe patinime, me dozim për m^2 : boj vaji kg 0,2 dhe me shumë duar për të patur një mbulim të plotë dhe perfekt të sipërfaqeve si dhe çdo gjë të nevojshme për mbarimin e plotë të lyerjes me bojë vaji në mënyrë perfekte.

Në përfundimin e punës kontraktori duhet të pastrojë komplet sheshin e ndërtimit dhe ta kthejë në kushtet e pranueshme dhe më të mira se gjendja e mëparshme.

Referenca dhe Standarte: Në këtë sektor, standardet Kombëtare, kur është e përshtatshme për përdorimin, mbizotërojnë. Sidoqoftë, kur Standardet kombëtare nuk mbulojnë një pjesë ose aktivitet të caktuar, do të përdoret standardi i përshtatshëm ndërkombëtar. Preferenca do t'i jepet standartit ISO.

Grafiku i Punimeve:

1	2	3. Afati i realizimit					
Nr	Përshkrimi i Punëve	Java 1	Java 2	Java 3	Java 4	Java 5	Java 6 (5 ditë)
1.	Skarifikim bari me lopatë						

2.	Preje e sistemim pemësh ø 21 ~ 40 cm						
3.	Gërmim dheu themele e plinta me b-2m, ekskavator me zinxhir 0.5m3,shkarkimi në auto						
4	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 10.0 km						
5	Prishje struktura prej betoni						
6	Brez b/a monolite C12/15						
7	Themel e xokol b/betoni C - 12/15						
8	Shtresë betoni C 12/15 me zgarë hekuri						
9	F.V. Hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm						
10	Mbulim çatie me panele sandwich						
11	Mur guri ne lartesi deri 3m me llaç çimento M25						
12	Mur me blloqe betoni 20cm, deri - 3m, me LL.P. M-15						
13	Suva fasade me granil e çimento të bardhë ~ 8m.						
14	F.V. portë metalike dekorative rrëshqitëse						
15	Bojë vaji sipërfaqe metalik						
16	Shtresë zhavori						
17	Ndërtim kangjella me panel çeliku i zinguar Ø4mm						

Preventivi

NR.	KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE.	NJËSIA	SASIA
		1. PUNIME SHPYLLËZIMI		
1	3.1	Skarifikim bari me lopatë	m ²	180
2	3.4	Preje e sistemim pemesh ø 21 ~ 40 cm	copë	5
		SHUMA 1:		
		2. PUNIME DHEU		
3	2.30a	Germim dheu themele e plinta me b-2m, ekskavator me zinxhir 0.5m3, shkarkimi në auto	m ³	35
4	2.1	Germim dheu me krah e transport k dore 10m, kat III	m ³	14

5	2.37/5b	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km	m ³	32
		SHUMA 2:		
		3. NDËRTIMI I VEPRAVE TË ARTIT+KANALIZIME		
6	3.405/1	Prishje struktura prej betoni	m ³	12
		SHUMA 3:		
		4. PUNIME BETONI DHE B/A		
7	2.691	Brez b/a monolite C12/15	m ³	62.1
8	2,110	Themel e xokol b/betoni C - 12/15	m ³	34.2
		SHUMA 4:		
		5. PUNIME HEKUR BETONI		
9	2.700	Shtresë betoni C 12/15 me zgarë hekuri	m ³	46
10	2.166	F.V. Hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm	ton	3.1
		SHUMA 5:		
		6. PUNIME HIDROIZOLIMI DHE ÇATITË		
11	2.256/b	Mbulim çatie me panele sanduich	m ²	72
		SHUMA 6:		
		7. PUNIME MURATURE GURI		
12	2.54/2	Mur guri në lartësi deri 3m me llaç çimento M 25	m ³	18
13	2.88	Mur me blloqe betoni 20cm, deri - 3m, me LL.P. M-15	m ³	13.6
		SHUMA 7:		
		8. PUNIME TAVANI DHE SUVATIMI		
14	2.343	Suva fasade me granil e çimento te bardhe ~ 8m.	m ²	345
		SHUMA 8:		
		9. PUNIME BOJATISJE		
15	2.415	F.V. Porte metalike dekorative rreshqitese	m ²	9
16	2.401	Bojë vaji siperfaqe metalik	m ²	70.2
		SHUMA 9:		
		10. NENSHTRESA DHE SHITRESA NE TERRITORIN E NDERTESAVE		
17	2.258/2	Shtresë zhavori	m ³	46
		SHUMA 10:		
		11. ANALIZA JASHTË LISTE		
18	An-1	Ndërtim kangjella me panel celiku i zinguar Ø4mm	m ²	672
		SHUMA 11:		

Afatet e realizimit të punimeve: Kohëzgjatja e kontratës do të jetë 40 (dyzetë) ditë kalendarike nga data e lidhjes së kontratës.

Në përfundim njësia e prokurimit;

Vendosi:

1. Miratimin e kriterëve të veçanta të procedurës së prokurimit me objekt “Sistemimi i varrezave të Himarës”.
2. Miratimin e specifikimeve teknike të objektit “Sistemimi i varrezave të Himarës”.
3. Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, neni 45, pika 2, kriter vlerësues të jetë: oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.
4. Procedura për hapjen e ofertave do të zhvillohet në datën 30.06.2025, ora 13⁰⁰

NJËSIA E PROKURIMIT